



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, me 12 shtator 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Agim Veliu Naim Maloku, Melihate Termkolli, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, dhe Zulf Merxha.

Munguan: Bojan Stojanovič.

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.07.2008**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Letërnjoftimin dhe Ligjit për tubimet publike**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët**
- 5. Shqyrtimi i rekomandimeve për situatën e sigurisë**
- 6. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me piken e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.07.2008

Kryesuesi, konstatoi se Procesverbali i mbledhjes së datës **22.07.2008**, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Letërnjoftimin dhe Ligjit për tubimet publike

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi tha, Ligji për Letërnjoftimin komisioni ne mbledhjen e mbajtur me 29 maj 2008 ka shqyrtuar dhe aprovuar plotësimin –amendamentet dhe tani këto do të procedohen me tej. Naim Maloku ka qenë referues dhe amendamentet janë harmonizuar edhe me Ministrinë për Punë të Brendshme.

Naim Maloku tha, ne si komision këtë ligj e kemi përfunduar, pra i kemi miratuar amendamentet që janë nxjerr gjatë shqyrtimit të këtij ligji, në bashkëpunim me sponsoruesin, pra që nga sot duhet të shikohet, se si duhet të procedohen ligjet që janë kthyer nga PSSP-ja, dhe ky ligj të procedohet për seancë plenare.

Kryesuesi njoftoi anëtarët e komisionit, se gjithashtu në rishqyrtim është kthyer edhe Ligji për Tubimet Publike, dhe tha se në konsultim më z.Agim Veliu, unë propozoi që Agim Veliu të caktohet referues për këtë ligj.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin e kryesuesit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët

Në këtë pikë kryesuesi tha, siç e dini ne ishim javën e kaluar në punëtorinë për këtë projektligj. Ligji ka kaluar në lexim të parë. Tani ne kemi dy mundësi. E para ta procedojmë në lexim të dytë, me propozim amendamente, por ka shume pasi që ka ndryshuar struktura e ligjit. Dhe e dyta të rekomandojmë, që Ministria e Punëve të Brendshme, të bëjë kërkesën për tërheqjen e ligjit dhe pastaj ligji të vij serish në lexim të parë. Hap debat për këtë çështje.

Naim Maloku tha, nga punëtorja e mbajtur në Istog për këtë projektligj, dhe duke e krahasuar projektligjin që ka kaluar në lexim të parë, me variantin e dytë të propozuar nga UNDP-ja dhe organizatat tjera, kemi vërejtur se është vështir të amendamentohet ky projektligj. Prandaj unë jam i pajtimit që ky projektligj ti kthehet sponsoruesit, që më pas sponsoruesi ta plotësoi në bazë të vërejtjeve që i kemi bërë në punëtori.

Agim Veliu, propozoi që të gjendet një formë, që vet komisioni të merret me hartimin e këtij projektligji e jo ti kthehet i gatshëm Qeverisë.

Emrush Xhemajli, unë them se është mirë ti kthehet sponsoruesit, sepse ndryshe mendoj se është proceduralisht e vështirë të bëhet, por unë kisha kërkuar, që gjatë ri-hartimit të merr pjesë edhe stafi i këtij komisioni.

Shkumbin Demaliaj tha, edhe unë kisha pas dëshirë të veprohet siç tha z.Agim Veliu, por nëse amendamentohet me ato ndryshime që i ka pësua projektligji gjatë punëtorisë në Istog, atëherë projektligji po tjetërsohet dhe për këtë arsye mendoj se është më mirë ti kthehet sponsoruesit.

Zafir Berisha, gjithashtu theksoi se pajtohet me propozimin e z.Agim Veliu, dhe kërkoi që të shikohet mirë, se a ka ndonjë formë procedurale, që ky projektligj të mbetet brenda komisionit për ri-hartim.

Naim Maloku tha, sponsoruesi ka të drejt ta tërheq projektligjin deri në lexim të dytë, por gjithashtu kemi edhe bazë ligjore, që ne vet komisioni të jemi sponsorizues të këtij projektligji. Por sinqerisht po ju them se kjo merr shumë punë dhe mendoj se nuk kemi kapacitet ta bëjmë një çështje të tillë, sepse nëse vendoset kështu, atëherë duhet të formojmë një grup punues, që do të përbëhej prej më shumë se gjysma e komisionit dhe duhet të kërkojmë ndihmë edhe nga ekspert të tjerë.

Kryesuesi kërkoj nga stafi, që të verifikohet se cila është mundësia më e mirë procedurale që të zgjidhet kjo çështje.

5. Shqyrtimi i rekomandimeve për situatën e sigurisë

Në këtë pikë kryesuesi tha, ju e dini se në mbledhjen e fundit të komisionit, kemi shqyrtuar një raport me rekomandime, për situatën e sigurisë. Ka mbetur që anëtarët e komisionit ta shqyrtojnë dhe të japin propozime për plotësimin e tyre.

Këto rekomandime janë lexuar para anëtarëve të komisionit dhe janë miratuar me disa ndryshime të vogla. Të gjithë anëtarët e komisionit janë pajtuar që këto rekomandime të procedohen për Kryesin e Kuvendit, që më pas të procedohen edhe për seancë plenare. Gjithashtu është kërkuar që këto rekomandime tu dërgohen edhe Institucioneve tjera relevante.

6. Të ndryshme

Kryesuesi i komisionit tha, Unë si kryetar i komisionit ju njoftoj se, tani po fillojmë me sesionin e ri të Kuvendit, prandaj kërkojë nga të gjithë anëtarët e komisionit, një angazhim më të madh. Fushëveprimi i Komisionit është shtuar, me formimin e Ministrisë së FSK-së dhe procesin e shpërbërjes së TMK-së. Pra kërkohet më shumë punë dhe angazhim nga ju. Po ashtu si komision do të fillojmë të realizojmë një serë takimesh dhe vizitash në Institucionet e Sigurisë, por edhe do të thërrasim në takime para komisionit në Kuvend.

Gjithashtu ka propozime dhe ide, për disa projekte të përbashkëta nga OCBE-ja, me shoqërinë civile, por në jemi të hapur për bashkëpunim. Të gjitha propozim idetë do të vinë në komision dhe ne bashkërisht do marrim vendim për to.
Pasi që ku ka dikush diçka tjetër për të shtuar, mbledhjen e deklaroi të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit